



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:066459
Datë: 13.08.2024
Numri i dokumentit: 06045106

K.Dh.Shk.II.nr. 1086/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit “Metalcom Plus” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811494666 me seli në fshatin Dobërllukë, Vushtrri, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Kastriot Feka., avokat nga Prishtina, kundër debitorit “Berto” L.L.C., me numër unik identifikues 810690372 me seli në Vushtrri, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Lirim Zeka, avokat nga Prishtina, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1341/23 të datës 04.04.2024, me datë **13.08.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit “Berto” L.L.C., me seli në Vushtrri, ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1341/23 të datës 04.04.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1341/23 të datës 04.04.2024, në dispozitiv të aktvendimit ka

refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit “Berto” L.L.C., me numër unik identifikues 810690372 me seli në Vushtrri, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarrimor P.nr. 834/23, i lejuar me datë 21.07.2023, nga Përmbarruesi Privat Atip Mustafa.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1341/23 të datës 04.04.2024.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e debitorit është e pathemeltë.**
-

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbarruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve të besueshme; Faturës nr. 19-2023, e datës 20.05.2023, ka lejuar Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 834/23, të datës 21.07.2023, me të cilin është urdhëruar debitori që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t’ia paguaj borxhin në shumë prej EUR 1,962.00, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarrimor, me arsyetimin se fatura mbi bazën e së cilës është iniciuar procedura përmbarrimore nuk është e përshtatshme për përmbarrim në kuptim të nenit 29 të LPP-së, dhe se e njëjta nuk është pranuar në mënyrë të rregullt, andaj nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë. Me tej, ka theksuar se fatura në fjalë nuk është e protokoluar nga ana e debitorit çka dëshmon se e njëjta nuk është pranuar në mënyrë të rregullt, ndërsa emri i personit i cili ka pranuar faturën nuk figuron si aksionar, pronar apo përfaqësuesi i autorizuar i debitorit. Në fund, ka theksuar se urdhri

përmbarrimor është nxjerr në kundërshtim me nenin 43.2 të LPP-së. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj në tërësi si të bazuar, urdhri përmbarrimor të shfuqizohet, si dhe shpenzimet në emër të përpilimit të prapësimin në shumën prej EUR 104.00.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorëve si të pabazuara, ndërsa lidhur me pretendimet se personi që ka nënshkruar faturën nuk është pronar apo person i autorizuar i debitorit është i paqëndrueshëm ngase kreditori shumë herë i ka dërguar fatura debitorit të cilat janë nënshkruar nga punonjësit e tij dhe jo pronari. Prandaj, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar, urdhri përmbarrimor të mbetet në fuqi, si dhe shpenzimet në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim sipas tarifave të parapara

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1341/23 të datës 04.04.2024, ku në dispozitiv të aktvendimit ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit “Berto” L.L.C., me numër unik identifikues 810690372 me seli në Vushtrri, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarrimor P.nr. 834/23, i lejuar me datë 21.07.2023, nga Përmbarruesi Privat Atip Mustafa.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se fatura mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbarrimor, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarrimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal dhe e nënshkruara nga debitori.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarrimi është lejuar në bazë të faturës të lëshuar nga kreditori, e cila faturë përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po që se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata e shkallës së dytë bazuar në Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh që *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është në dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, konsideron se fatura si dokument në sajë të cilës kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, ka prova se është pranuar dhe nënshkruar nga debitori, prandaj konsiderohet si dokument i besueshëm. Po ashtu, fatura është dorëzuar në kopje të vërtetuar nga origjinali dhe mbanë nënshkrimin e pranimit nga ana e debitorit. Andaj, fatura nr. 19-2023, e datës 20.05.2023, është nënshkruar nga debitori dhe konsiderohet si pranimit i rregullt.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit se fatura nuk është nënshkruar në mënyrë të rregullt nuk është nënshkruar nga personat përgjegjës, dhe nuk është vulosur nga debitori, por që këto pretendime i vlerësoj si të pabazuara, pasi që në vlerësimin e Gjykatës, me nënshkrimin e faturës mbi bazën e të cilës është lejuar përmbartimi dhe atë pa kundërshtim është pajtuar me borxhin që rrjedh nga fatura.

Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K.DH.SH.II nr.1086/24 me datë 13.08.2024

Gjyqtari

Faton Bajrami